



REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 424 / 22

Nr. i fq. / Br. st -05-

Data: / Datum 24.03.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



ODA E HOTELIERISË DHE TURIZMIT TË KOSOVËS
OHTK
PRISHTINË
Nr. 00046 dt. 24/03 20 22

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

ODËS SË HOTELIERISË DHE TURIZMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës dhe Komuna e Vushtrrisë pajtohen të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me qëllim të shtrirjes dhe zgjerimit të veprimtarisë së përbashkët, zgjerimit të mundësive për projekte të përbashkëta, të ndihmës reciproke për promovimin e benifiteve që ofron Oda si dhe inkurajimin e nismave me qëllim të promovimit të pasurive natyrore dhe mundësive turistike që ka Vushtrria.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët palët nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me përmbajtjen e mëposhtme:

Neni 1
Qëllimi

Qëllim kryesor i këtij Memorandumi është koordinimi i aktiviteteve dhe thellimi i bashkëpunimit në mes të Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës dhe Komunës së Vushtrrisë për arritjen e objektivave të përbashkëta në fushën e hotelierisë dhe turizmit e në theks të veçantë bashkëpunimi për realizimin e projekteve që synojnë promovimin e resurseve natyrore, vlerave të trashëgimisë kulturore dhe turistike që i ka kjo zonë e Kosovës.

Neni 2 Autoritetet

Ky memorandum do të realizohet nga:

- Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës (OHTK) dhe nga
- Komuna e Vushtrrisë

(në tekstin e mëtejme palët)

Neni 3 Detyrat dhe përgjegjësitë e palëve

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi zotohen së do të japin kontributin e tyre maksimal për realizimin e projekteve nëpërmjet të të cilave prezantohen vlerat dhe pasuritë natyrore e turistike të Komunës së Vushtrrisë duke vënë theksin edhe tek promovimi i trashëgimisë së kësaj zone e cila është shumë e larmishme dhe e pasur.

1. Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës zotohet se do të bashkëpunoj sinqerisht me Komunën e Vushtrrisë duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe resurset e saja njerëzore që i ka në dispozicion për jetësimin e projekteve të përbashkëta.
2. OHTK-ja do të shfrytëzoj dhe do të vë në dispozicion të gjitha kapacitetet e veta me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësiave që dalin nga nënshkrimi i këtij memorandum.
3. Komuna e Vushtrrisë do të jap kontributin e saj maksimal duke vënë në shërbim të realizimit të projekteve, ideve dhe qëllimeve të përbashkëta gjithë potencialin njerëzor si dhe duke i mbështetur këto projekte edhe financiarisht atëherë kur është e mundur dhe e nevojshme.
4. Komuna e Vushtrrisë do t'i pranoj dhe do të shkëmbej me përfaqësuesit e OHTK-së, përvojat më të mira nga projektet dhe aktivitetet e mëparshme të natyrës së njëjtë.
5. OHTK-ja dhe Komuna e Vushtrrisë do të bashkëpunojnë dhe do të zhvillojnë aktivitete e takime të përbashkëta, nëpërmjet të përfaqësuesve të deleguar, të cilët do të krijojnë grupe punuese.
6. Përfaqësuesit e deleguar nga palët janë të obliguar që për rrjedhën e aktiviteteve dhe rezultatet e projekteve të punojnë raporte të rregullta dhe të njëjtat t'i prezantojnë para organeve udhëheqëse të institucionit që i ka deleguar.

7. Palët, nëpërmjet të përfaqësuesve të tyre do të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta dhe do të koordinojnë të gjithë hapat më qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të projekteve për promovimin e resurseve dhe trashëgimisë së kësaj zone.

Neni 4 Konfidencialiteti i të dhënave

- Të dyja palët janë të obliguara që të mbajnë konfidencial çdo informacion që është miratuar në këtë Memorandum dhe nëse është paraqitur në mbështetje të qëllimit për të cilin është bërë kërkesa.
- Të gjitha informacionet e miratuara sipas këtij Memorandumi janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen nga njëra palë pa pëlqimin e palës tjetër.

Neni 5 Zbatimi

- OHTK-ja dhe Komuna e Vushtrisë përcjellin mënyrën e jetësimit të këtij memorandumi nga ana e përfaqësuesve të tyre.
- Palët mund të japin udhëzime dhe direktiva se cilat veprime duhet marrë për implementimin e projekteve dhe kryerjen e obligimeve deri në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Neni 6 Përfaqësimi i palëve

Secila palë përfaqësohet nga persona fizik të deleguar nga ta me autorizim në formë të shkruar.

Neni 7 Mundësia e ndërprerjes së memorandumit dhe rrethanat e paparashikuara

- Ndërprerja e Memorandumit të bashkëpunimit bëhet me marrëveshje miqësore ndërmjet palëve.
- Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të rrethanave të krijuara nga fuqitë madhore (vis maior) apo rrethanave tjera të paparashikuara, palët me marrëveshje do të vendosin për veprimet që do të ndërmarrin lidhur me memorandumin.

Neni 8 Amandamenti

- Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin unanimit të të dyja palëve.
- Ky Memorandum mund të ndryshohet ose plotësohet në çdo kohë nga palët me marrëveshje me shkrim. Mbi të gjitha, çfarëdo kushti i caktuar që nuk është precizuar në këtë Memorandum, për të cilin palët pajtohen për t'u integruar në tekstin e tij apo për t'a plotësuar atë si amendament të nënshkruar nga palët do të konsiderohet si pjesë integrale e këtij dokumenti.

Neni 9 Kohëzgjatja (afati i realizimit) dhe zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

- Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është në vullnetin e lirë të palëve sipas vlerësimit të tyre diskrecional.
- Ky memorandum bashkëpunimi lidhet nga palët pa ndonjë afat të caktuar dhe është i vlefshëm për sa kohë palët kanë interes të përbashkët.
- Palët do të mundohen që paqartësitë dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi t'i zgjedhin në mënyrë miqësore dhe me bisedime.
- Përfundimi i këtij Memorandumi në rast të mosmarrëveshjeve në mes palëve nuk krijon ndonjë obligim ligjor për asnjërën prej tyre.
- Njoftimi për ndërprerje të këtij Memorandumi nga njëra prej palëve kontraktuese nuk do të ndikojë në zbatimin e aktiviteteve të filluara para ndërprerjes së marrëveshjes.

Neni 10 Efektet e përfundimit të memorandumit në mënyrë të njëanshme

- Ky Memorandum do të mbetet në fuqi derisa njëra nga palët të njoftojë palën tjetër me shkrim se do të rishikojë, ndryshojë apo edhe të tërhiqet nga Memorandumi. Secila palë mund të përfundojë këtë Memorandum duke njoftuar me shkrim palën tjetër.
- Memorandumi do të quhet i përfunduar ditën kur pala ta ketë marrë njoftimin me shkrim për tërheqjen e palës tjetër nga Memorandumi.
- Ndërprerja me vullnet të njëanshëm e Memorandumi nuk krijon pasoja juridike për asnjërën nga palët nënshkruese.

- Pala që është tërhequr me vullnet të njëanshëm nga Memorandumi është e obliguar që të i ofrojë palës tjetër të gjitha të dhënat që i ka në dispozicion e që lidhen me realizimin e projektit.
- Të dyja palët janë të obliguara që edhe pas përfundimit të Memorandumit të vazhdojë të ruajnë të dhënat konfidenciale nëse ka të tilla.

Neni 11
Hyrja në fuqi

- Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e palëve.
- Nënshkruar në *Vushtrri, më 24/03/2022*, në dy kopje autentike në gjuhën shqipe.

Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës

Kryetari
Dr.Sc. Hysen SOGOJEVA



A blue circular stamp of the Chamber of Hospitality and Tourism of Kosovo is partially visible behind the signature. The stamp contains the text 'ODHA E HOTELIERISË DHE TURIZMIT TË KOSOVËS' and 'CHAMBER OF HOSPITALITY & TOURISM OF KOSOVO'. The signature is written in blue ink over a horizontal line.

Komuna e Vushtrrisë

Kryetari
Ferit IDRIZI



A blue circular stamp of the Municipality of Vushtrri is partially visible behind the signature. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVËS', 'KOMUNA E VUSHTRRIË', and 'OPSTINA VUČITRICE'. The signature is written in blue ink over a horizontal line.